



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KOMISIONIN
NDËRKOMBËTAR PËR EKSPLORIMIN SHKENCOR NË DETIN MESDHE”**

❖ HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në komisionin ndërkombëtar për eksplorimin shkencor në detin Mesdhe”.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishin përfaqësues të ministrisë për turizmin dhe mjedisin.

Relator për shqyrtimin e këtij projektligji ishte deputetja Evis Kushi.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj syrtohet me procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjeve, mbështetur në nenin 28 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, si dhe kontribuimin e vendit tonë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve që kontribuojnë në këtë det.

Komisioni integron një spektër të gjerë të disiplinave detare, duke përfshirë proceset gjeo-fizike, kimike dhe biologjike, së bashku me hartat me rezolucion të lartë të fundit të detit. Ndryshimet në Detin Mesdhe po ndodhin në mënyrë të shpejtë dhe të pashembullt. Është pikërisht Komisioni që gjurmon dhe analizon këto ndryshime, të cilat vijnë nga ndikimi i ngrohjes globale në nivelin e detit dhe masat ujore deri te ndryshimet në biodiversitetin detar.

KNESHDM-ja përfshin në aktivitetet e tij studiues nga të gjitha brigjet e Basenit. Duke qenë se Deti Mesdhe është një trashëgimi shekullore, shtetet kanë si objektiv të mundësojnë shkëmbimin e standardeve dhe ideve shkencore, por edhe të mbajnë një dialog konstruktiv, paqësor midis tyre pasi për një kohë të gjatë, ato kanë qenë të ndarë nga konfliktet historike.

Shtetet nënshkruese, angazhohen për një periudhë pesëvjeçare e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër prej pesë vjetësh. Shtetet nënshkruese mbështesin një rrjet me disa mijëra studiues detarë, të cilët përdorin mjetet më të fundit shkencore për të kuptuar, monitoruar dhe mbrojtur më mirë Detin Mesdhe i cili po ndryshon shpejt dhe po sjell ndikime të mëdha.

Me anëtarësimin në këtë Komision, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

III. EFEKTET FINANCIARE

Për sa i takon efekteve financiare të projektligjit, angazhimi si anëtar i Komisionit Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe sjell si pasojë detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor të përcaktuar nga Byroja. Kuota e Shqipërisë kap vlerën prej 25 000 eurosh, kuotë e cila është në detyrimin e Ministrisë për Turizmin dhe Mjedisin.

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Fillimisht projektligji u prezantua nga përfaqësuesit e ministrisë për turizmin dhe mjedisin, të cilët qartësuan arsyet e këtij propozimi, shpjeguan punën e Komisionit Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, si dhe kontributin që pritet të japë vendi ynë.

Deputetja, relatore për komisionin u shpreh se nëpërmjet anëtarësimit në këtë komision, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Deputetët, anëtarë të komisionit, pasi u interesuan mbi efektet financiare të projektligjit, si dhe benefitet që do të gëzojë Shqipëria nëpërmjet këtij anëtarësimi, vlerësuan nismën e propozuar dhe e miratuan atë.

V. PËRFUNDIME

Pas shqyrtimit të projektligjit, në përfundim të mbledhjes, Komisioni për Politikën e Jashtme, vlerësoi se:

- a) *në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *në aspektin procedural* është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

EVIS KUSHI

KRYETARE

MIMI KODHELI